

A do të bëhet ministër Lube Boshkoski? Ja çfarë thotë

Maqedonia

Postuar nga: redaksia

Postuar në: 2017/11/14 7:11:31



Lideri i partisë “Të Bashkuar për Maqedoninë”, Lube Boshkoski, së shpejti do të bëhet ministër dhe për atë është rezervuar njëra nga vendet e lira ministrore. Sipas informatave jo-zyrtare të “Fokus-it”, Boshkoski do të ulet në karrigen e Ramiz Merkos, i cili deri para se të zgjidhej kryetar i Qytetit të Strugës, ishte ministër pa resor, njofton Portalb.mk.

Në një deklaratë për “Fokus”, Boshkoski thotë se ende nuk është informuar për kështu vendimi dhe se tani për tani bëhet fjalë për spekulim

“Askush zyrtarisht s’më ka informuar për kështu vendimi”, thotë Boshkoski i cili nuk mohon se ka pasur bisedime partiake për këtë temë.

Boshkoski ishte pjesë e ekipit të LSDM-së, në zgjedhjet lokale, por vetëm ka dhënë mbështetje nëpërmjet partisë së tij, duke mos kandiduar për asnjë funksion.

/portalb